

## **PJETËR BELESHI**



Auditues i Lartë në Departamentin e Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm, KLSH. Lindur në vitin 1951. Diplomuar në Ekonomi, dega Kontabilitet(1974). 39 vite eksperiencë pune. 18 vitet e fundit në KLSH. Auditues i Lartë nga viti 2010. Fusha e ekspertizës: Auditimi i financave publike.

## **KONTABILITETI I ANGAZHIMEVE<sup>1</sup>**

*nga Pjetër Beleshi*

Në ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare janë përcaktuar parimet dhe rregullat e përgjithshme për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe për mbajtjen e kontabilitetit të cilat janë të detyrueshme për të gjitha njësitë ekonomike që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë. Këto njësi janë të detyruar të organizojnë mbajtjen e kontabilitetit mbi bazën e parimeve dhe të metodave, të përcaktuara në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Nga auditimet e kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në shumë njësi të qeverisjes së përgjithshme konstatohet se nuk është praktikuar mbajtja e kontabilitetit mbi bazën e ***të drejtave të konstatuara*** ose të ashtuquajturit ***kontabilitet i angazhimeve***. Mbajtja kontabilitetit sipas parimit të të drejtave të konstatuara, do të thotë që të ardhurat dhe shpenzimet të kontabilizohen që në momentin e lindjes së të drejtave ose detyrimeve ndaj të tretëve. Tepër i domosdoshëm është mbajtja e kontabilitetit të angazhimeve në të gjitha subjektet që kryejnë investime të mëdha me të tretë siç është rasti i

Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARSH), i Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizimeve (DPUK), i Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë (QSUT), i njësive të Pushtetit Vendor dhe i të gjitha subjekteve që lidhin kontrata disa vjeçare për investime apo për shërbime të ndryshme disa vjeçare.

Në udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 2, datë 06.02.2012 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*” është përcaktuar se, nëpunësi zbatues i njësisë respektive regjistron kontratën sipas rastit në kontabilitetin e menaxhimit, përpilon dokumentin e afateve të pagesës dhe paraqet dokumentacionin si më sipër në gjuhën shqipe me njoftimin përfundimtar zyrtar për shpalljen e fituesit në strukturën përgjegjëse për thesarin në degë brenda tre ditëve pune nga nënshkrimi i tyre. Struktura përgjegjëse për thesarin evidenton vlerën totale të çdo kontrate dhe bën regjistrimin në sistemin informatikë, duke bërë bllokimin e fondeve për shpenzim, pra regjistrohet angazhimi.

Por në fakt nuk ndodh kështu pasi, nga auditimet që ka kryer KLSH në shumë njësi ekonomike rezulton se ato regjistrojnë në kontabilitetin e tyre vetën vlerën e investimeve të financuar nëpërmjet thesarit brenda parashikimit buxhetor, por jo vlerën e angazhimit të marrë dhe as vlerën e detyrimit të mbetur pa u financuar në fund të ushtrimit.

Sipas të dhënave që disponon sektori i financës në një nga njësitë ekonomike më të mëdha në Shqipëri për financimin e investimeve të mëdha, bazuar në kontratat e lidhura deri më 31.12.2012, vlera totale e investimeve të kontraktuara është rreth **2,7 miliard lekë**, vlera totale e financuar deri më 31.12.2012 është **2,1 miliard** lekë dhe shuma e mbetur për t’u financim më 31.12.2012 është rreth **0,6 miliard** lekë. Aktualisht në kontabilitetin e kësaj njësie, janë pasqyruar vetëm transaksionet e bëra për financimin e punimeve

të kryera të bazuar në situacionet e dorëzuara në sektorin e financës në përputhje me fondet e çelura dhe të rakorduara me thesarin në shumën **2,1 miliard** lekë, *por nuk është bërë regjistrimi i angazhimit (kontratave fillestare)* e për rrjedhojë *nuk pasqyrohet në kontabilitet vlera e kontratave bazë të lidhura dhe as detyrimi progresiv në fund të vitit buxhetor* në shumën rreth **0.6 miliard lekë** dhe që konsiderohet si detyrim i shtetit për tu financuar në periudhat e ardhshme.

Sipas të dhënave të raportuara nga Ministria e Punëve Publike dhe Transporteve në Ministrinë e Financave më 31.12.2012 rezulton se vlera fillestare e kontratave të lidhura për *rrjetin e Ujësjellës Kanalizime* që financohen nga buxheti i shtetit është rreth **4.4 miliard** lekë, ndërsa detyrimi i mbetur për t'u financuar është rreth **2.4 miliard** lekë. E njëjta situatë është raportuar më 31.12.2012 për *rrjetin Rrugor Nacional* ku vlera fillestare e kontratave të lidhura që financohen nga buxheti i shtetit është rreth **63.4 miliard** lekë, ndërsa detyrimi i mbetur për tu financuar është rreth **41.3 miliard** lekë. Pra vetëm për këto të dy institucione raportohet nga evidencat statistikore rreth **67,8 miliard** lekë vlera e angazhimeve të marra dhe rreth **43.7 miliard** lekë vlera e detyrimeve për të tretë e mbetur për t'u financuar më 31.12.2013, por këto angazhime dhe vlera e detyrimeve të mbetura nuk regjistrohen në kontabilitet dhe nuk pasqyrohen në pasqyrat financiare.

Gjatë auditimit të ushtruar, u konstatua se Ministria e Financave nuk ka të evidentuar *detyrimet ndaj operatorëve ekonomikë* për punë publike, mallra ose shërbime të kontraktuara dhe/ose të kryera. Referuar domosdoshmërisë së evidentimit të tyre për të patur një pasqyrim sa më të drejtë të detyrimeve afatshkurtra dhe afatmesme në pasqyrat financiare të shtetit, por edhe për të realizuar një planifikim të kujdesshëm të buxhetit për periudhat në vijim **KLSH ka rekomanduar**, marrjen e masave nga Ministria e Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit)

për evidentimin e saktë të, të gjitha detyrimeve ndaj sipërmarrësve privatë të angazhuar në realizimin e punëve publike, mallra dhe shërbime dhe planifikimin e shlyerjes së tyre në buxhetet afatshkurtër apo afatmesëm.

Pra kontabiliteti dhe pasqyrat financiare që hartojnë njësitë ekonomike, nuk pasqyrojnë realisht angazhimet dhe as detyrimet e institucioneve ndaj të tretëve duke “maskuar” detyrimet që shteti ka ndaj sipërmarrësve (të tretëve).

Nisur nga shqetësimet e trajtuara më lart është i domosdoshëm mbajtja e kontabilitetit të angazhimeve sipas parimit të, të *drejtave të konstatuara*, i cili bën të mundur dokumentimin (nxjerrjen në çdo moment dhe me saktësi), në kontabilitetin e njësive ekonomike të vlerës së detyrimeve fillestare bazuar në kontratat e lidhura, ndryshimet e bëra në kontratë nga palët gjatë zbatimit të kontratave, vlerës së punimeve të kryera në përputhje me grafikët e punimeve, vlerën e financiar në fakt sipas planit buxhetor vjetor dhe vlerën e detyrimit të pa financiar në fund të vitit buxhetor që konsiderohet si detyrime të fshehura.

Mbajtja e kontabilitetit sipas këtij parimi dhe paraqitja e këtyre të dhënave në bilancet financiare të çdo njësie ekonomike do t'i bënte pasqyrat financiare më transparente, të besueshme, të vërteta, të krahasueshme dhe të kuptueshme për përdoruesit e tyre dhe për publikun në përgjithësi, i cili është i interesuar të dijë të vërtetën ashtu siç është pa shtrembërime dhe kamuflime.

---

<sup>i</sup> Botuar në Gazetën “Ekonomia” dt. 13 Nëntor, 2013